



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Udhezues për Aplikantët
Nën thirrjen Europe Aid/155863/DD/ACT/AL
Numri i referencës së projektit: 2017/394-893

Projekti
Gratë në Iniciativë
Skema e aplikimit të Nën-grantit

Autoriteti Grant-dhënës: Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” Shkodër

Në partneritet me: COSPE, Italy

Afati i fundit për dorëzimin e projekt propozimeve: 17 Mars 2020 ora 17.⁰⁰(me orën lokale)



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



PËRMBAJTJA

1.1 HYRJE

Projekti W.IN – Gratë në Iniciativë - është një iniciativë 3 –vjeçare (2018-2021) e implementuar në Shqipëri nga Shoqata COSPE (Cooperazione per lo Sviluppo dei Paesi Emergenti) në partneritet me Qendrën e Gruas “Hapa të Lehtë” me seli në Shkodër, Shqipëri, në bashkëpunim me bashkitë Vau i Dejës, Pukë dhe Tropojë.

Projekti W.IN financohet nga Bashkimi Evropian nën programin “Veprimet Lehtësuese të Shoqërisë Civile 2016-2017 – Në mbështetje të kapaciteteve të organizatave të Shoqërisë Civile, për Shqipërinë (Europe Aid/155863/DD/ACT/AL). Është një projekt 36 mujor.

Në kuadër të projektit, fondi W.IN ka si qëllim të mbështesë organizatat lokale të grave dhe grupeve të grave me grante të vogla, duke rritur pjesmarrjen e tyre aktive në politikat publike dhe në menaxhimin e kapaciteteve për të menaxhuar iniciativa në favor të grave.

Nën-grantet do të shpërndahen vetëm me qëllim për të nxitur iniciativa koherente me marreveshjet dhe Planin e veprimit të negociuar midis partnerëve të projektit, grupeve të grave dhe organizatave të grave në secilën bashki.

Në secilën bashki, janë identifikuar axhendat e grave me prioritetet specifike, në përputhje me nevojat dhe kushtet të secilit kontekst dhe buxhetin përkatës.

Një Komitet Vlerësimi është ngritur, duke përfshirë përfaqësues të COSPE-s, Qendrës së Gruas “Hapa të Lehtë” dhe një ekspert me të drejtë vote. Për të lehtësuar procesin e vlerësimit, do të ketë një përfaqësues nga secila bashki, një sekretar dhe një Kryetar Komisioni, pa të drejtë vote.

Iniciativat nga organizatat e grave dhe grupeve të grave do të përzgjidhen nëpërmjet mekanizmit të Thirrjes për Projekt Propozime.

Kjo thirrje për projekt propozime do të publikohet nën fondin W.IN në bashkitë konkrete.

Shuma totale e vënë në dispozicion për këtë thirrje ishte 133.000 EUR, nga te cilat, kane mbetur pa u shpenzuar 19005 euro për Bashkine Puke

Ashtu sic është cituar edhe në thirrjen e pare, nëqoftëse kjo shumë nuk do të shpërndahej plotësisht, do të publikohej një thirrje e dytë.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES PËR PROPOZIME

Objektivat e kësaj thirrje për propozime janë:

- Inkurajimi i pjesëmarrjes të organizatave të shoqërisë civile lokale dhe grupeve të grave në hartimin, aplikimin dhe implementimin e projekteve bazuar në prioritete të vendosura nga vetë gratë dhe të shprehura në axhendat gjinore të secilës bashki.
- Rritjen e nivelit të aktivizimit të organizatave dhe grupeve të grave në zonat më të thella në promovimin e të drejtave të grave në komunitetet e tyre, në bashkëpunim me institucionet lokale.
- Rritjen e kapaciteteve të organizatave të grave të zonave rurale në zbatimin dhe menaxhimin aktiviteteve të mbështetura nga EU.

1.3 SHUMA FINANCIARE E SIGURUAR NEPËRMJET AUTORITETIT TË NËN – GRANTIT

Shuma totale në dispozicion të kësaj Thirrje Për Propozime është 19,005 EUR.

Shuma e Granteve:

Çdo kërkesë për mbështetje nën këtë Thirrje për Propozime duhet të jetë midis shumës minimale dhe maksimale:

Shuma minimale: 5.000 EUR

Shuma maksimale: 10.000 EUR

Shpërndarja e fondeve do të realizohet vetëm për Bashkinë Pukë:

Bashkia Pukë: 19005 EUR

Nuk kërkohet bashkëfinancim. Buxheti total i projektit do të mbulohet nga Autoriteti i Nën-Grantues.

Kohëzgjatja e projektit duhet të jetë 8 muaj.

Projekti duhet të zbatohet në territorin e Bashkisë Pukë duke përfshirë të gjitha njësitë administrative te saj.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



2. RREGULLAT PËR KËTË THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME

Ky udhëzues vendos rregullat për hartimin, përzgjedhjen dhe zbatimin e Projekteve të financuara nën këtë Thirrje për Projekt Propozime.

Udhëzuesin mund ta gjeni në:

COSPE ONLUS website në linkun:

<https://www.cospe.org/posizioni-aperte/58929/albania-win-subgrant-cfp>

Qendra e Gruas “Hapa të Lehtë” website në linkun: www.hapatelehte.org

2.1 KRITERET E LEJUESHME

Kriteret e lejueshme ndahen në tre fusha të cilat janë:

1) Aktorët:

Aplikanti, psh. Autoriteti i cili dorëzon aplikimin (2.1.1),

2) Fusha e veprimet:

Fushat e veprimit për të cilat mund të jepet nën-granti (2.1.2),

3) Shpenzimet:

Llojet e shpenzimeve të vlefshme për dhënien e shumës së nën-grantit (2.1.3).

2.1.1 APLIKANTËT E LEJUESHËM

Për të përfituar një mbështetje nga Fondi W.IN nëpërmjet thirrjes për projekt propozime, aplikuesi duhet të jetë:

- Organizata formale, organizatat formale të grave, siç janë shoqatat apo OJQ;
- Grupe joformale të grave që ekzistojnë/vazhdojnë aktivitetin e tyre (duhet të kenë të paktën 5 gra anëtare)
- Iniciativa të përkohshme të grave të krijuara në kuadër të Thirrjes për Projekt Propozime (duhet të kenë të paktën 5 gra anëtare)

Për më tepër aplikanti duhet:

- Të jetë krijuar/themeluar dhe të veprojë nën juridiksionin e bashkisë Pukë.
- Të jetë direkt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projekt-propozimeve.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



(2) Thirrja është e hapur vetëm për organizatat lokale, organizatat e grave, grupet formale dhe joformale të grave të cilat plotësojnë kriteret e sipërpërmendura dhe që veprojnë në territorin e bashkisë **Pukë me eksperiencë në fushën e të drejtave të grave, barazisë gjinore, lobimit për të drejtat e grave dhe fuqizimit socio-ekonomik.**

2.1.2. AKTIVITETE E LEJUESHME:

Përkufizimi Një projekt duhet të ketë një sërë aktivitete të cilat kanë si qëllim të arrijnë rezultatet e pritshme dhe objektivat specifik.

Kohëzgjatja Planifikimi i kohëzgjatjes së Projektit duhet të jetë 8 muaj.

Sektorët ose temat Sektorët specifikë ose temat me të cilat duhet të lidhet projekti janë ato që kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave dhe përparësive specifike, sipas pikës 1.2.

Vendodhja Veprimet duhet të shtrihen në territorin e bashkisë Pukë.

Llojet e veprimeve të lejueshme (por jo të kufizuara në):

Sektorët specifikë ose temat me të cilat duhet të lidhen Propozimet janë ato që kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave dhe përparësive të listuara sipas pikës 1.2.

Aplikanti duhet të sigurojë që Propozimi është në linjë me statutin, eksperiencën dhe ekspertizën e organizatës/grupeve të grave.

Disa nga prioritetet dhe aktivitetet që do të adresohen në propozim janë si më poshtë;

Lista e veprimeve:

- Zhvillimi dhe implementimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere me burra, gra dhe të rinjë në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me parandalimin e dhunës dhe abuzimit kundër grave, duke ofruar gjithashtu shërbime sociale.
- Zhvillimi dhe implementimi i aktiviteteve që kontribuojnë për të përmirësuar rolin e grave dhe për të promovuar të drejtat e tyre në familje dhe komunitet, përmes mediave sociale;
- Organizimi i aktiviteteve socio-kulturore dhe sportive për gratë dhe të rinjtë së bashku me Bashkinë;
- Mbështetja e fuqizimit socio- ekonomik të grave përmes kurseve profesionale;
- Implementimi i aktiviteteve në rrjet me aktorët vendorë, përgjegjës për pjesëmarrjen e grave në proceset e vendimmarrjes;
- Promovimi i nismave lokale në turizëm, zhvillimi ekonomik lokal përmes iniciativave të drejtuara nga gratë dhe autoritetet vendore;



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Note: Lista e veprimeve nuk është shteruese dhe aktivitetet të tjera që nuk janë përmendur më lart mund të jenë gjithashtu të lejueshme.

Aktivitetet promovuese dhe ndërgjegjësuere mund të jenë pjesë e Propozimit, por nuk mund të jenë veprimet kryesore.

Propozimet e palejueshme:

- Propozime që kanë të bëjnë vetëm ose kryesisht me mbështetjen financiare të individëve për pjesëmarrje në workshope, seminare, konferenca ose kongrese;
- Propozime që kanë si qëllim të vetëm ose kryesisht bursa individuale për studime ose kurse trajnimi
- Propozime që mbështesin zgjedhjet e partive politike ose kandidatëve; financimi për projekte tashmë në zbatim ose të përfunduara;
- Propozime për përfitimin ekskluzivisht të individëve ose grupeve të individëve;
- Bashkë-financimi i aplikantit (kur buxheti është kryesisht për shpenzime organizative/operative)
- Veprimet humanitare;
- Veprime që kanë të bëjnë vetëm me ndërtim/rikonstruksion (Propozime që lidhen vetëm me ndërtim ose rikonstruksion nuk janë të lejueshme);

Llojet e aktiviteteve të pranueshme

Sektorët specifikë ose temat me të cilat duhet të lidhen aktivitetet janë ato që kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave dhe përparësive të listuara sipas pikës 1.2.

Aplikantët inkurajohen të propozojnë aktivitetet të tjera nga ato të treguara më poshtë, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në arritjen e objektivave dhe përparësive specifike të listuara në pikën 1.2.

Lista e aktiviteteve:

- Krijimi i klubeve sociale, kënde lojrash për fëmijë ose modele të bazuara në komunitet apo shërbime për të moshuar.
- Kurse profesionale në kuzhinë, përpunim fruta-perime, shërbime hotelerie, rrobaqepësi, parukeri, zejtari, aftësim me shkathtësi për punë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të grave për të drejtat e tyre, pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen, duke realizuar aktivitetet me gratë përfaqësuese të këshillave bashkiakë.
- Promovimi i turizmit përmes panairove, tryezave të rumbullakta, zyrës së markave turistike (brands) etj.
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi shëndetin e gruas, kancerin e gjirit, shëndetin riprodhues.
- Aktivitete që përfshijnë djem dhe burra në luftën e stereotipeve dhe normave kulturore mbi dhunën me bazë gjinore dhe barazinë gjinore.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Shënim: Lista e aktiviteteve nuk është shteruese, dhe aktivitete të përshtatshme të pa listuara më sipër mundet gjithashtu të jenë të lejueshme.

Numri i aplikimeve dhe granteve për aplikantët

Aplikantët nuk mund të paraqesin më shumë se një (1) Propozim nën këtë Thirrje për Propozime. Aplikantëve nuk mund t'u jepet më shumë se një (1) nën-grant nën këtë Thirrje për Propozime.

Vizibiliteti

Aplikantët duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të bërë publike faktin që Bashkimi Evropian ka financuar ose bashkëfinancuar projektin.

Aplikantët duhet të respektojnë (detyrimin kontraktues) me objektivat dhe përparësitë e projektit W.IN dhe të garantojnë vizibilitetin e financimit të BE-së, sipas Manualit të Komunikimit dhe Vizibilitetit për veprimet e jashtme të BE-së, të specifikuara dhe të publikuara nga Komisioni Evropian në lidhje: https://ec.europa.eu/europeaid/communication-and-visibility-manual-eu-external-actions_en

2.1.3. Kosto të pranueshme: kosto që mund të përfshihen

Vetëm kostot e pranueshme mund të mbulohen nga një nën-grant sipas këtij Udhëzuesi për Projekt Propozime. Kategoritë e kostove që janë të pranueshme dhe jo të pranueshme tregohen më poshtë. Rimbursimi i kostove të pranueshme do të bazohet në buxhetin e aprovuar, të specifikuar në njësi dhe kostot e njësi.

Në fazën e kontraktimit, Autoriteti i nën-grantit vendos nëse do të pranojë shumat ose tarifat e propozuara në bazë të buxhetit të përkohshëm të paraqitur nga aplikuesit, duke analizuar të dhënat faktike të granteve të kryera nga aplikantët ose veprime të ngjashme.

Rekomandimet për dhënien e një granti gjithmonë i nënshtrohen kushteve, ku kontrollet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës së grantit të mos evidentojnë probleme që kërkojnë ndryshime në buxhet (siç janë gabimet aritmetike, pasaktësitë, kostot joreale dhe kostot e palejueshme). Kontrollet mund të ngrejnë kërkesa për sqarime dhe mund të bëjnë që Autoriteti i Nën-grantit të imponojë modifikime ose zvogëlime për të adresuar gabimet ose pasaktësitë. Nuk është e mundur të rritet granti si rezultat i këtyre korrigjimeve.

Prandaj është në interesin e aplikantëve të paraqesin një buxhet realist dhe me kosto efektive.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Kostot direkte të pranueshme

Janë kostot aktuale të bëra nga përfituesi i Nën-grantit që plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- (a) Ato janë bërë gjatë zbatimit të Projektit. Një angazhim për shpenzime në formën e një kontrate, porosie ose një forme tjetër të bërë brenda periudhës së zbatimit por që do të përfundojë pas periudhës së zbatimit të projektit, nuk është një shpenzim i pranueshëm.
- (b) Ato tregohen në buxhetin e përgjithshëm të vlerësuar për Projektin.
- (c) Ato janë të domosdoshme për zbatimin e Projektit.
- (d) Ato janë të verifikueshme dhe të identifikueshme duke përdorur mjetet e duhura.

Kosto të papranueshme

Kostot e mëposhtme nuk janë të pranueshme:

- Taksat, duke përfshirë taksat mbi vlerën e shtuar (TVSH)
- Gjobat, gjobitjet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor;
- Pajisjet e dorës së dytë, përveç nëse sigurohet një arsytim i duhur dhe shpenzimet aprovohen paraprakisht nga Autoriteti i Nën - Grantit;
- Tarifat bankare, kostot e garancive dhe tarifatat e ngjashme, përveç kostove të mirëmbajtjes së llogarisë bankare
- Kostot e konvertimit, tarifatat dhe humbjet e këmbimit të lidhura me shpenzimet në Eur, si dhe shpenzimet e tjera thjesht financiare;
- Kontributet në natyrë;
- Kostot e zhvlerësimit;
- Borxhet dhe tarifatat e shërbimit të borxhit;
- Humbjet e këmbimit të valutës;
- Kostot e deklaruara nga përfituesi i nën-grantit dhe të financuara nga një projekt ose punë tjetër e programuar;
- Kredi për palët e treta;
- Kostot e pagave të personelit të organeve lokale dhe kombëtare të Administratës Publike.
- Parashikime për humbje ose detyrime të mundshme në të ardhmen.
- Detyrimi i interesit.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



2.2. SI TË APLIKOHET DHE PROCEDURA QË DUHET TË NDIQET

2.2.1. Forma e aplikimit

Aplikimet duhet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet e Formularit të Aplikimit (Shtojca A). Aplikantët duhet të aplikojnë në shqip ose anglisht.

Ju lutemi vini re se vetëm Formulari i Aplikimit (Shtojca A), Formulari i Buxhetit (Shtojca B) dhe Korniza Logjike (Shtojca C) do të vlerësohen. Prandaj është e rëndësishme që këto dokumente të përmbajnë të **GJITHË** informacionin përkatës në lidhje me Propozimin. Asnjë aneks shtesë nuk duhet të dërgohet, përveç dokumenteve mbështetës që lejojnë Autoritetin Nën – grantues të verifikojë pranueshmërinë e aplikantit.

Dokumentet mbështetëse që duhen dorëzuar:

Organizata formale, organizatat formale të grave, siç janë shoqatat apo OJQ

1. Ekstrakt gjykate
2. NIPT-i i organizatës
3. Deklarata nga Autoritetet Rajonale Tatimore që deklarojnë se organizata nuk ka detyrime financiare ndaj palëve të treta.

Për grupet joformale të grave:

1. Kopja e letërnjoftimeve të të gjithë pjesëmarrësve të grupit (të paktën 5 gra)
2. Deklarata e grupit e hartuar para një noteri që shpreh vullnetin e të gjithë grupit që do të aplikojë në këtë Thirrje për Propozime.
3. Aplikimi i Propozimit duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit.

Çdo gabim ose mospërputhje në lidhje me pikat e listuara në udhëzim ose ndonjë mospërputhje në formularin e aplikimit (p.sh. nëse shumat në fletët e buxhetit nuk janë në përputhje) mund të çojnë në refuzimin e aplikimit.

Aplikimet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Sqarimet do të kërkohen vetëm kur informacioni i dhënë nuk është i mjaftueshëm për Autoritetin e Nën-grantit për të bërë një vlerësim objektiv.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



2.2.2. Ku dhe si të dërgoni aplikimin

Aplikanti duhet të paraqesë / dërgojë formularin e plotë të aplikimit (Shtojcën A - Formularin e Aplikimit, Shtojcën B-Buxhetin, Shtojcën C-Kornizen Logjike) në një zarf të mbyllur, një në origjinal dhe 2 kopje në madhësinë A4, secila të nënshkruar. Dokumentet mbështetëse, gjithashtu, duhet të futen në zarf. Forma e plotë e aplikimit gjithashtu duhet të sigurohet në format elektronik (CD-ROM / USB) në të njëjtën zarf. Dosjet elektronike duhet të përmbajnë saktësisht të njëjtën kërkesë si versionet e letrës të bashkangjitura.

Zarfi i jashtëm duhet të ketë:

- Numri i referencës së projektit WIN: 2017 / 394-893
- Titulli i Thirrjes për Propozime: "Gratë në Iniciativë - Skema e Aplikimit për Nën-Grant"
- Emrin dhe adresën e plotë të aplikantit

Aplikimet duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur me postë të regjistruar, shërbim korrier privat ose me dorëzim (një dokument i nënshkruar me datën dhe orën e dorëzimit do t'i jepet dorëzuesit) në adresën e mëposhtme:

Adresa postare: Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë": Rruga e Murgeshave, Nr.6, Kodi 4001, Shkodër, Shqipëri.

Aplikimet e dërguara me çfarëdo mënyre tjetër (p.sh. me faks ose me postë elektronike) ose dërgohen në adresat e tjera do të refuzohen. Aplikimet me shkrim me dorë nuk do të pranohen. Çdo aplikant duhet të verifikojë që aplikimi i tij është i plotë. Aplikimet Jo të plota do të refuzohen.

2.2.3. Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve

Afati i fundit për paraqitjen e aplikimeve është **17 Mars 2020** siç vërtetohet nga data e dërgimit, ose dorëzimit në postë. Në rastin e dërgesave me dorë, afati i fundit për pranim është **data 17 Mars 2020 ora 17:00** me orën lokale ashtu siç vërtetohet nga marrja në dorëzim e zarfit dhe nënshkrimi i dates dhe orës. Çdo aplikim i paraqitur pas këtij afatit automatikisht do të refuzohet.

2.2.4. Informacione të mëtejshme në lidhje me aplikimet

Gjithashtu, pyetjet mund të dërgohen me postë elektronike, në anglisht ose në shqip, jo më vonë se 10 ditë para afatit të fundit për paraqitjen e aplikimeve në llogarinë e postës elektronike: gendragruashk@yahoo.com, duke treguar qartë referencën e Thirrjes për Propozime



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Autoriteti i Nën -Grantit nuk ka asnjë detyrim të japë sqarime për pyetjet e marra pas kësaj date. Përgjigjet do të jepen Jo më vonë se 7 ditë para afatit të fundit për paraqitjen e aplikimeve. **Në mënyrë që aplikantët të kuptojnë më mirë paketën e aplikimit, Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" dhe COSPE do të zhvillojnë një Sesion të hapur Informimi për aplikantët e mundshëm Bashkinë Pukë.**

Për të siguruar trajtim të barabartë të aplikantëve, Autoriteti Nën-grantues nuk mund të japë një mendim paraprak mbi pranueshmërinë e aplikantëve, aktivitetet dhe kostot.

Të gjitha informacionet në lidhje me këtë Thirrje për Propozim do të publikohen në faqet e

COSPE ONLUS website në linkun:

<https://www.cospe.org/posizioni-aperte/58929/albania-win-subgrant-cfp>

Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" website në linkun: www.hapatelehte.org

duke përfshirë datën dhe kohën e Sesionit të Informimit.

Prandaj është e këshillueshme që të konsultoheni rregullisht me web-faqet e lartpërmendur, në mënyrë që të informoheni në kohë.

2.3 VLERSIMI DHE PËRZGJEDHJA E APLIKIMEVE

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Grant-dhënës.

Të gjitha Propozimet e paraqitura nga aplikantët do të vlerësohen sipas hapave dhe kriterëve vijuese.

Nëse gjatë shqyrtimi të aplikimit konstatohet se kriteret e pranueshmërisë nuk janë përmbushur, kërkesa do të refuzohet mbi këtë bazë të vetme.

2.3.1. HAPI 1: HAPJA DHE KONTROLI ADMINISTRATIV

Gjatë hapjes dhe kontrollit administrativ, do të vlerësohen kriteret e mëposhtme:

- Përputhshmëria me afatin e paraqitjes. Nëse afati nuk është përmbushur, aplikimi automatikisht do të refuzohet.

- Formulari i Aplikimit plotëson të gjitha kriteret e specifikuar në tabelën më poshtë. Nëse ndonjë nga informacionet e kërkuara mungon ose nuk është i saktë, aplikimi mund të refuzohet dhe nuk vlerësohet më tej.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Aplikantët do të informohen me shkrim për vendimin e Autoritetit Grant-dhënës në lidhje me aplikimin e tyre dhe, nëse refuzohen, për arsyet e këtij vendimi.

Komisioni i Vlerësimit do të vazhdojë më tej me aplikimet që kanë kaluar kontrollin administrativ.

Kriteret e para që duhet të përmbushen nga secili aplikim janë renditur në tabelën më poshtë:

| KRITERET ADMINISTRATIVE | PO | JO | KOMENTE |
|--|-----------|-----------|----------------|
| Afati i aplikimit është përmbushur. | | | |
| Paketa dhe formati i aplikimit janë përdorur sipas udhëzimit të publikuar. | | | |
| Propozimi është i printuar. | | | |
| Propozimi është në gjuhën shqipe/angleze. | | | |
| Aplikimi është i paraqitur ne original dhe në kopje. | | | |
| Dosja elektronike (CD-ROM ose USB) përmbanë ekzaktësisht të njëjtin aplikim sikurse version i mbyllur në letër. | | | |
| Kriteret e lejueshme | PO | JO | KOMENTE |
| 1. Pranueshmëria e aplikantit: Aplikimi paraqitet nga një aplikant i lejueshëm | | | |
| 2. Zona: Propozimi duhet të zbatohet në bashkinë Pukë. | | | |
| Buxheti i projektit: Buxheti i përgjithshëm i projektit është në përputhje me shumat minimale dhe maksimale siç janë publikuar në Udhëzues. | | | |
| Kohëzgjatja e Projektit duhet të jetë 8 muaj | | | |
| Aplikuesi ka paraqitur vetëm një propozim për këtë Thirrje për Propozime. | | | |
| Të gjitha dokumentat mbështetëse janë dorëzuar: Organizata formale, organizatat formale të grave, siç janë shoqatat apo OJQ 1. Ekstrakt gjykate 2. NIPT-i i organizatës 3. Deklarata nga Autoritetet Rajonale Tatimore që deklarojnë se organizata nuk ka detyrime financiare ndaj palëve të treta. | | | |
| Për grupet joformale të grave: 1. Kopja e letërnjoftimeve të të gjithë pjesëmarrësve të grupit (të paktën 5 gra) 2. Deklarata e grupit e hartuar para një noteri që shpreh vullnetin e të gjithë grupit | | | |



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



| | | | |
|--|--|--|--|
| që do të aplikojë në këtë Thirrje për Propozime. 3. Aplikimi i Propozimit duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e grupit. | | | |
|--|--|--|--|

2.3.2. HAPI 2.VLERËSIMI I APLIKIMIT

Aplikimet që kalojnë kontrollin administrativ do të vlerësohen më tej në cilësinë e tyre, përfshirë buxhetin e propozuar, kornizën logjike dhe kapacitetin e aplikantit. Kriteret e vlerësimit të përdorur janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Këto kritere ndihmojnë për të vlerësuar cilësinë e aplikimeve në lidhje me objektivat dhe përparësitë e përcaktuara në udhëzim, dhe për të dhënë grante për projekte që maksimizojnë efektivitetin e përgjithshëm të thirrjes për propozime.

Ato ndihmojnë në përzgjedhjen e aplikimeve për të cilat Autoriteti Grant-dhënës, Qendra e Gruas dhe COSPE mund të jenë të sigurt se do t'i zbatojnë objektivat dhe përparësitë e tij.

Ato vlerësojnë rëndësinë e Propozimit, përputhjen e tij me objektivat e Thirrjes për Propozime, cilësinë, ndikimin e pritshëm, qëndrueshmërinë dhe kostot-efektive.

Tabela e vlerësimit është e ndarë në seksione dhe nënseksione. Çdo nënseksion do t'i jepet një rezultat midis 1 dhe 5 si më poshtë: 1 = shumë i dobët; 2 = i dobët; 3 = i përshtatshëm; 4 = mirë; 5 = shumë mirë.

| Nëndarje | Maksimumi I pikëve |
|---|--------------------|
| 1. Kapaciteti financiar dhe operativ | |
| 1.1. A ka aplikanti përvojë në menaxhimin e projekteve të ngjashme? | |
| 1.2. A ka aplikanti ekspertizë të mjaftueshme teknike (veçanërisht njohuri për çështjet që duhen adresuar)? | |
| 1.3. Aplikanti ka aftësi të mjaftueshme menaxhuese (përfshirë stafin, pajisjet) për menaxhimin e suksesshëm të projektit? | |
| 2. Përputhshmëria e Projektit | |
| 2.1. Sa përputhet Propozimi me objektivat dhe përparësitë e Thirrjes? | |
| 2.2. Sa të përcaktuara dhe të zgjedhura qartë janë ata të përfshirë (grupet e synuara, përfituesit përfundimtarë)? | |
| 2.3 A janë përcaktuar qartë nevojat e grupeve të synuara dhe përfituesve përfundimtarë dhe a i adreson Propozimi ato siç duhet? | |
| 3. Efektiviteti dhe realizueshmëria e projektit | |



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



| | |
|---|--|
| 3.1. A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhje me objektivat dhe rezultatet e pritura? | |
| 3.2. A është plani i veprimit i qartë dhe i mundshëm? | |
| 3.3. A përmban Propozimi indikatorë të verifikueshëm objektivisht për rezultatin e Projektit? | |
| 4. Qëndrueshmëria e projektit | |
| 4.1. A ka gjasa që Propozimi të ketë një ndikim të prekshëm në grupet e tij të synuara? | |
| 4.2. A ka gjasa që Propozimi të ketë efekte shumëzuese (përfshirë hapësirën për përsëritje, shtrirje dhe shkëmbim informacioni)? | |
| 4.3. A janë rezultatet e pritura të Propozimit të qëndrueshme?: (1) financiarisht: si do të financohen aktivitetet pasi të përfundojë Nën-granti?; (2) institucionalisht: a do të ekzistojnë strukturat që lejojnë të vazhdojnë aktivitetet në fund të projektit?; (3) në nivelin e politikave: cili do të jetë ndikimi strukturor i Projektit (a do të çojë ai në përmirësim të legjislacionit, kodet e sjelljes, metodat, etj.); (4) faktorë të rëndësishëm që mund të ndërpresin aktivitetet: mjedisi, diskriminimi, paaftësia, etj.: A do të ketë propozimi një ndikim negativ/pozitiv në mjedis, në diskriminime të kundërta, në mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, etj? - Si do të sigurohet pronësia lokale e rezultateve të Projektit? | |
| 5. Buxheti dhe efektiviteti i kostos së Propozimit | |
| 5.1. A janë pasqyruar drejtë aktivitetet në buxhet? | |
| 5.2. A është i kënaqshëm raporti ndërmjet kostove të vlerësuara dhe rezultateve të pritshme? | |
| Maksimumi total i pikëve | |

Pas vlerësimit, do të hartohet një tabelë ku do të renditen aplikimet sipas rezultateve të tyre. Aplikimet me rezultatin më të lartë do të zgjidhen përkohësisht derisa të arrihet buxheti në dispozicion për këtë Thirrje për Propozime.

Për më tepër, një listë rezervë do të hartohet duke ndjekur të njëjtat kritere. Kjo listë do të përdoret nëse do të ketë më shumë fonde të disponueshme gjatë periudhës së vlefshmërisë së listës rezervë.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



2.3.3 HAPI 3: VERIFIKIMI I PRANUESHMËRISË SË APLIKANTIT

Verifikimi i pranueshmërisë do të kryhet vetëm për aplikimet që janë zgjedhur përkohësisht sipas rezultatit të tyre dhe brenda buxhetit të disponueshëm për këtë Thirrje për Propozime.

Për më shumë:

-dokumentet mbështetëse të siguruara nga aplikanti do të kontrollohen, dhe çdo mosrespektim mund të çojë në refuzimin e kërkesës vetëm bazuar mbi të.

Pranueshmëria e aplikantëve do të verifikohet në bazë të kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1.1, 2.1.2 dhe 2.1.3.

Cdo aplikimi i refuzuar do të zëvendësohet nga aplikimi tjetër pasardhës në listë, që përputhet më buxhetin në dispozicion të kësaj thirrje.

Aplikuesi, aplikimi i të cilit është zgjedhur përkohësisht ose është vendosur në listën rezervë, do të informohet me shkrim nga Autoriteti Grant-dhënës.

2.4. KUSHTET PËR ZBATIM PAS DHËNIES TË NËN-GRANTIT NGA AUTORITETI GRANT-DHËNËS.

Pas vendimit për dhënie e një nën-granti, përfituesit nëshkruan një kontratë bazuar në kontratën standarte të nën-grantit.

3. LISTA E ANKESEVE

- Aneks A: Forma e Aplikimit (Formati Word)
- Aneks B: Buxheti (Formati Excel)
- Aneks C: Korniza logjike (Formati Word)